



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.12.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 674, të datës 10.11.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për nëntë mujorin e vitit 2014, në shumë të përgjithshme prej 4,574,408.40€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në Administratë buxheti i shpenzuar është 1,703,263.83€,
 - 2.2 Në Arsim buxheti i shpenzuar është 2,073,276.75€,
 - 2.3 Në Shëndetësi buxheti i shpenzuar është 778,777.93€ dhe
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 19,089.89€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Buxhet.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FB dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.12.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 142, të datës 13.11.2014, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62 të datës 16.05.2013, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2015 në përbërje prej
 - 1.1 Fadil Krasniqi - Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryetar i grupit,
 - 1.2 Hasan Gjyrevci, Zyrtar ligjor, anëtar i grupit,
 - 1.3 Milaim Berjani, përfaqësues i LDK-së, anëtar i grupit,
 - 1.4 Sokol Duraku, përfaqësues i PDK-së, anëtar i grupit,
 - 1.5 Elmi Shabani, përfaqësues i LVV-së, anëtar i grupit,
 - 1.6 Ali Ismaili, përfaqësues i PD-së, anëtar i grupit,
 - 1.7 Shaban Ademi, përfaqësues i AKR-së, anëtar i grupit,
 - 1.8 Hasan Krasniqi, përfaqësues i AAK-së, anëtar i grupit,
 - 1.9 Qerim Gara, Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, përfaqësues i PDAK-së, anëtar i grupit,
 - 1.10 Miroslav Veličkoviç, Kryesues i Komitetit për Komunitete, përfaqësues i GIS-it, anëtar i grupit.
- 2 Detyrë e Grupit Punues është hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa, Komitetit për Komunitete dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2015. Plani Vjetor i Punës shqyrtohet dhe aprovohet nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.12.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 330, të datës 18.09.2014, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 6, paragrafi 1, pika 1.2, nenin 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), nenin 17 shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dhënien e 'Pëlqimit' për konfirmimin e Planit Zhvillimor Komunal të komunës së Fushë-Kosovës për periudhën 2013-2023, sipas shkresës Nr. 5075/13 të datës 30.12.2013 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
2. Planit Zhvillimor Komunal përfshinë pjesën tekstuale dhe grafike, ndërsa realizimi dhe rregullimi i hapësirës në territorin e komunës së Fushë-Kosovës bëhet konform Planit Zhvillimor Komunal.
3. Për zbatimin e procedurave për realizimin e Planit Zhvillimor Komunal, është kompetent Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Drejtoria për Inspektorat.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për PU, Drejtorisë për INSPK dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Nr.Br. 156 dt. 10.12.2014

Datë: 04.12.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 383, të datës 07.11.2014, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 22, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 8, nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për lëshimin e Lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastructures Nr. 22/2012, nenin 17 shkronja (b, d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b, ç), nenin 27, shkronja (f, nj) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për lejin e zbatimit të taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin 2015, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, të miratuar prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vlera si vijon:
 - 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore gjatë vitit fiskal 2015, është në vlerë prej 2.81.00€/m² bruto.
 - 2.2 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë gjatë vitit fiskal 2015, është në vlera prej 114.90€ për kokë banori, e cila llogaritet sipas formulës së paraparë njësia e re banuese 50m² - për kokë banori x 114.90€ = njësinë e re banuese x 2.30€/m² neto.
3. Realizimi, llogaritja dhe caktimi i taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë nga pika dy (2) e këtij Vendimi, do të bëhet nga Drejtoria për Planifikim Urban.
4. Për zbatimin e këtij vendimi është kompetent Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Drejtoria për Inspektorat.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për PU, Drejtorisë për INSPK dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

MP. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.12.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 718, të datës 19.11.2014, paraqitur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7, nenin 27, shkronja (g) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Prof. Dr. Mentor Sopjani, Profesor Universitar në degën e biologjisë, nga fshati Harilaç zgjedhet, "Krijues për vitin 2014", në komunën e Fushë-Kosovës.
2. I lartëcekuri gëzon privilegjet e parapara për titullin "Krijues i vitit 2014" në komunën e Fushë-Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, z. Mentor Sopjani dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Radil Krasniqi

